

There are no translations available.

Në kuadrin e zhvillimit të Konferencave të Rrethëve me datë 05.07.2014 u mbledh Konferenca Zgjedhore e Rrethit Krujë me pjesëmarrjen e 49 delegateve që përfaqësojnë 7 seksione të Sindikatave të Rrethit, me një anetaresë të përgjithshme prej 1470 anetaresh. Në Konferencë morën pjesë të deleguarit e Keshillit Kombëtar të BSPSH-së Presidenti i saj z. Gëzim Kalaja, z. Sami Kariqi Zv/President i BSPSH, si dhe monitoruesi i konferencave zgjedhore Sekretari Organizativ z. Koço Jani. Raporti në emër të Keshillit Sindikal të Rrethit Krujë u mbajt nga Kryetar i këtij Keshilli z. Engjell Çollaku, i cili paraqiti aktivitetin 5-vjeçar të anetaresës sindikale të Rrethit dhe si probleme të rëndësishme, çështjet e zbatimit në vijë të përgjithshme të vendimeve të Forumeve Qendrore të BSPSH, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave social - ekonomike të punonjësve, çështjet e marrëdhënieve të mira dhe bashkëpunimit të ndërsjellë me punëdhënësit e ndërmarrjeve, me Zyrat Rajonale të Punes, të konkretizuara me lidhjen e nente kontratave kolektive, sipas profesioneve të ndryshme sindikale.

Raporti trajtoi problemet e organizmit dhe të mbështetjes konkrete të protestës së punonjësve të fabrikave të Çimentos ndaj masave shtrenguese – bllokuese të Ministrisë së Tregëtisë së Kosovës, siç ishte rasti i ngritjes së tarifës doganore të çimentos shqiptare në 35% , e cila demtonte rëndë interesat e punonjësve dhe influenconte negativisht si në uljen e pagave dhe në atë të largimeve masive nga puna. Rreth raportit pati edhe diskutime nga delegatet të cilët vlerësuan në përgjithësi aktivitetin e Keshillit Sindikal të Rrethit, por kerkuan nga kjo strukturë gjallëri në organizim sidomos në çështjet e mbrojtjes së vendeve të punës, si nga punëdhënësi publik ashtu edhe nga ai privat. Konferencën e përshëndeti Presidenti i BSPSH, i cili në fjalën e tij i kushtoi rëndësi të madhe gjendjes reale të punonjësve në kuadrin e krizës botërore dhe masave shtrenguese të programit qeveritar të kushtëzuar nga FMN-ja, të cilat do të ndikonin në uljen e nivelit të standartit të jetesës, sidomos me vendosjen e taksave të reja dhe ngritjen e çmimit të energjisë elektrike. Midis të tjerave Presidenti i BSPSH zoti Kalaja i njohu pjesëmarrësit të Konferencës me politikën e qeverisë për zbatimin e reformës në fushën e pensioneve dhe me qëndrimet e BSPSH ndaj projekt-ligjit të paraqitur, ku BSPSH –ja është shprehur qartë dhe me argument për mosngritjen e moshës së daljes në pension, për grate mbi 63 vjeç dhe për burrat mbi 65 vjeç, si dhe kërkesën për ndryshimin e formulës së llogaritjes së pensionit duke kërkuar ruajtjen e të drejtave të përfitimit të pensioneve sipas ligjit aktual ekzistues. Konferenca Zgjedhore në fazën e dytë kaloi në procedurat e votimit për zgjedhjen e drejtuesit të Keshillit Sindikal të Rrethit si dhe të deklaramentit të votave me mandate përfaqësimi për kandidatin për president të BSPSH, të cilat u monitoruan nga Sekretari Organizativ i BSPSH. Në fund Komisioni i Votimit të Konferencës pas verifikimit të votave shpalli z. Engjell Çollaku, kryetar të BSP Krujë.

